

VENDIM
Nr. 698, datë 16.8.2013

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË
KOMUNËS KOMSI TË QARKUT TË DIBRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Koms i të qarkut të Dibrës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 104 (njëqind e katër) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 921 (nëntëqind e njëzet e një).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Koms i për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Koms i

Lidhja nr. 1

Numra rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-6	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
9, 11-18	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
19-35	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e shërbimit funeral	Në pronësi
36-37, 40-43, 45-47, 50-51, 53-65	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e trojeve të lira e hapësirave publike	Në përdorim
38-39, 48-49, 52, 407-409, 411-413, 415, 417-418, 420-421, 423-431, 433-434	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
44	Prona infrastrukture (sheshe, lulishte)	Në pronësi
410, 414, 416, 419, 422, 432, 435, 436-448	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive)	Në pronësi
249, 252	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e mbrojtjes	Në pronësi

70-247	Infrastrukturë (rrugë vendore, shërbime publike)	Në pronësi
--------	--	------------